



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK  
I TIRANËS



DREJTORIA E SIGURIMIT TË  
INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS DHE DREJTORISË SË  
SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

PËR

ZHVILLIMIN E PROJEKTEVE ME INTERES TË PËRBASHKËT,  
SHKËMBIMIN E PËRVOJËS DHE KRYERJEN E PRAKTIKAVE MËSIMORE

Tiranë, me 4 Korrik 2018

## **Preambul**

Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), në vijim të quajtura *Palë*;

*Duke vlerësuar rëndësinë e aftësisë së burimeve njerëzore për zhvillimin e teknologjisë dhe inovacionit në fushën e sigurisë;*

*Duke konfirmuar vullnetin dhe angazhimin e përbashkët;*

*Duke u mbështetur në kuadrin ligjor që rregullon reciprokisht veprimtaritë institucionale:*

Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit Politeknik i Tiranës (UPT);

Ligji nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi;

*Bien dakord, të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi, në vijim i quajtur Memorandum.*

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij Memorandum është :

- a. Nxitja e organizimit dhe e zhvillimit të veprimtarive të përbashkëta ndërmjet Palëve për realizimin e projekteve dhe të aktiviteteve me interes të ndërsjellët;
- b. Shkëmbimi i eksperiencave dhe kryerja e praktikave mësimore të studentëve, në funksion të përgatitjes së specialistëve të rinj të kualifikuar, referuar kërkesave të tregut të punës, si dhe
- c. Aftësimi i burimeve njerëzore për zhvillimin e kapaciteteve teknologjike në fushën e sigurisë.

## **Neni 2**

### **Objekti**

1. Memorandumi ka si objekt:

- a. Shkëmbimin e përvojës së dyanshme të palëve në lidhje me menaxhimin institucional.
- b. Realizimin e aktiviteteve dypalëshe, si dhe të publikimeve të përbashkëta kërkimore shkencore.
- c. Pjesëmarrjet e përbashkëta të palëve në konferenca, seminare, evente dhe takime në interes të kërkimit shkencor e profesional.
- ç. Kryerjen e praktikave dhe të proceseve mësimore të studentëve të UPT pranë ambienteve dhe zyrave të DSIK, ose institucioneve të tjera me të cilat DSIK ka marrëveshje bashkëpunimi.
- d. Organizimin e përbashkët të leksioneve të hapura dhe të trajnimeve profesionale në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes së informacionit.
- e. Bashkëpunimin mes DSIK dhe UPT lidhur me:
  - Përgatitjen e temave kërkimore shkencore me interes për veprimtarinë e institucioneve të sigurisë,
  - Përgatitjen e temave të diplomave të studentëve të UPT dhe ofrimi nga DSIK i ekspertizës profesionale për realizimin e tyre, kryesisht në fushën e sigurimit të sistemeve të komunikimit,
  - Ofrimin e ekspertizës nga ekspertët e DSIK në funksion të përsosjes së kurrikulës së kurseve të ofruara nga UPT në fushën e sigurisë kibernetike, referuar dinamikës dhe zhvillimeve më të fundit teknologjike.

## **Neni 3**

### **Roli dhe përgjegjësitë e Palëve**

1. Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi realizohet si vijon:

### 1.1. UPT:

- a. Përcakton pikën e kontaktit për ndjekjen e aktiviteteve dhe të veprimtarive të përbashkëta me DSIK.
- b. I propozon DSIK listën e aktiviteteve në funksion të formimit profesional të studenteve dhe angazhohet për realizimin e tyre në përputhje me nevojat e veprimtarisë akademike dhe të kërkimit shkencor.
- c. Shkëmben informacion me DSIK në lidhje me projektet, konferencat botimet shkencore dhe aktivitetet me interes të përbashkët.
- ç. Shkëmben informacion me DSIK lidhur me tematikat kryesore të zhvillimit të praktikës mësimore të studentëve të UPT dhe rakordon masat e përbashkëta për realizimin e tyre sipas një grafiku të rënë dakord më parë nga palët, duke përfshirë datat, oraret e praktikave, numrin dhe identitetin e pjesëmarrësve, si dhe çdo informacion tjetër në funksion të mbarëvajtjes dhe të sigurisë.
- d. Merr masa përkatëse disiplinore ndaj studentëve, që gjatë kryerjes së praktikës mësimore, nuk respektojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, cenojnë mbarëvajtjen normale të punës dhe dëmtojnë bazën materiale teknike të DSIK.

### 1.2. DSIK

- a. Përcakton pikën e kontaktit për ndjekjen e aktiviteteve të përbashkëta me UPT, projekteve dhe të kërkimeve në funksion të veprimtarisë së institucioneve të sigurisë dhe të mbrojtjes së informacionit.
- b. I propozon UPT listën e aktiviteteve, projekteve dhe të kërkimeve me interes të përbashkët në funksion të veprimtarisë së institucioneve të sigurisë dhe të mbrojtjes së informacionit, si dhe angazhohet për realizimin e tyre.
- c. Merr masa për atashimin dhe kryerjen e praktikave profesionale të studentëve të miratuar të UPT pranë specialistëve dhe ekspertëve në ambientet e DSIK.
- ç. Shkëmben informacion me UPT lidhur me performancën individuale të studenteve praktikantë dhe formalizon lëshimin e vërtetimit përkatës, sipas modaliteteve të përcaktuara nga Palët.
- d. Shkëmben informacion me UPT në lidhje me takimet, projektet, konferencat e botimet shkencore me interes në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes së informacionit.

### 1.3. Palët marrin përsipër të kryejnë bashkërisht:

- a. Caktimin e grupeve të përbashkëta të punës për studimin dhe formalizimin e projekteve me interes shkencor e profesional;
- b. Organizimin e leksioneve të hapura dhe pjesëmarrjen në trajnime profesionale të eksperteve dhe lektorëve në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes së informacionit;
- c. Hartimin e pyetësorëve të vlerësimit të aktiviteteve të përbashkëta dhe të modeleve për certifikimin e pjesëmarrësve.

#### **Neni 4**

##### **Komunikimi i ndërsjellët**

1. Palët do të shkëmbejnë rregullisht informacion të dyanshëm në lidhje me të gjitha çështjet e parashtruara në këtë Memorandum.
2. Komunikimi i ndërsjellët dhe çdo informacion tjetër në funksion të zbatimit të kërkesave të këtij Memorandumi do të realizohet përmes pikave të kontaktit të Palëve, duke përdorur postën elektronike zyrtare.
3. Kur Palët bien dakord, përdoren edhe mënyra të tjera për shkëmbimin e informacionit dhe të komunikimit të ndërsjellët.
4. Gjatë komunikimit shkresor ose elektronik për zbatimin e këtij Memorandumi, pikat e kontaktit të Palëve, angazhohet t'i japin përgjigje njëra tjetrës sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë kalendarike.

#### **Neni 5**

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Palët do të sillen me korrektësi gjatë përmbushjes së detyrimeve reciproke dhe ushtrimit të veprimtarisë së tyre, pa cenuar interesat e njëra-tjetrës.
2. Gjatë realizimit të kërkesave të Memorandumit, Palët do të zbatojnë në mënyrë reciproke kërkesat e legjislacionit në fuqi, lidhur me veprimtaritë e tyre institucionale.
3. Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi, zgjidhet me negociim e mirëkuptim ndërmjet Palëve.

## **Neni 6**

### **Buxheti**

1. Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i këtij Memorandumi i nënshtrohen legjislacionit në fuqi dhe janë brenda kufijve të shpenzimeve buxhetore që Palët kanë dispozicion.
2. Palët do të përballojnë kostot financiare për zbatimi i këtij Memorandumi nga buxhetet respektive.

## **Neni 7**

### **Konfidencialiteti**

1. Palët janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave dhe të informacioneve të përftuara gjatë zbatimit të Memorandumit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
2. Ky detyrim është i vlefshëm pa afat kohor.

## **Neni 8**

### **Shtesat dhe ndryshimet**

1. Ky Memorandum mund të ndryshojë përmes negociimit paraprak të çështjeve dhe vetëm me marrëveshje ndërmjet Palëve.
2. Çdo ndryshim reflektohet me shkrim dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve.

## **Neni 9**

### **Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Memorandumit**

1. Memorandumit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe publikohet i plotë brenda 10 ditëve kalendarike në faqet zyrtare të Palëve.

2. Kohëzgjatja e këtij Memorandumi është deri kur njëra nga Palët kërkon zyrtarisht ndërprerjen e bashkëpunimit.
3. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, 2 (dy) prej të cilave depozitohen në Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT) dhe 2 (dy) kopje në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

**Nënshkruar në Tiranë, më 4 Korrik 2018**


**Universiteti Politeknik  
i Tiranës**

  
**Prof. Dr. Andrea MALIQARI**

**Rektor**

**Drejtoria e Sigurimit  
të Informacionit të Klasifikuar**



  
**Dorian TOLA**

**Drejtor**